

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
MISIONI NË KOSOVË

Ekzekutimi i Aktgjykimeve

Janar, 2012

Mohim përgjegjësie:

Versioni i këtij publikimi në gjuhën angleze është versioni zyrtar. Gjitha versionet e këtij publikimi në gjuhët tjera janë përkthim nga versioni origjinal në anglisht, si dhe nuk janë dokumente zyrtare.

TABELA E PËRMBAJTJEVE

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	2
1.HYRJE	3
2. KORNIZA LIGJORE	5
A) Standardet Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut	5
B) Ligji Vendor.....	7
Legjislacioni civil.....	7
Legjislacioni Penal.....	9
C) Zhvillimet e Fundit në Kornizën Normative.....	10
3. PËRMBARIMI I AKTGJYKIMEVE CIVILE NË KOSOVË	11
4. EKZEKUTIMI I AKTGJYKIMEVE PENALE NË KOSOVË.....	15
5. PËRFUNDIM	17
6. REKOMANDIME	18

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Vonesat e mëdha dhe mangësitë procedurale në përmbarrimin/ekzekutimin e aktgjykimeve civile dhe penale në gjykatat në Kosovë dëmtojnë të drejtën për gjykim korrekt brenda kohës së arsyeshme dhe komprometojnë sundimin e ligjit. Në veçanti, rastet përmbarrimore që përfshijnë aktgjykime për fatura të papaguara për shërbime komunale janë veçanërisht problematike si për shkak të numrit të madh të tyre ashtu edhe për shkak të pasaktësive në propozimet për përmbarrim që kompanitë e shërbimeve komunale i parashetrojnë pranë gjykatave. Madje edhe më problematike janë rastet që përfshijnë subjekte publike si debitorë të aktgjykimeve. Shumë shpesh, kur urdhërohet të zbatohet aktgjykimin kundër vetes, komuna ose ndonjë tjetër subjekt publik mundohet të vonojë përmbarrimin me ankesa dhe kundërshtime të pabaza. Çfarë është edhe më keq, shpesh ato thjeshtë shpërfillin aktgjykimet e tilla.

Sa i përket përmbarrimit të aktgjykimeve civile, shpesh ka vonesa ndërmjet kohës së shpalljes së aktgjykimit verbal dhe atij me shkrim. Adresat e pasakta për të pandehurit shpesh rezultojnë në vështirësi për të gjetur vendndodhjen e të dënuarve kur gjoha ose dënimi me burg marrin formën e prerë dhe bëhen të ekzekutueshme. Ka po ashtu mungesë të trajnimit për referentët që janë përgjegjës për përmbarrimin e këtyre aktgjykimeve.

Në përgjigje të këtyre gjetjeve, OSBE fton institucionet e Kosovës që të ndërmarrin veprim të shpejtë për të plotësuar kornizën legjislative në atë mënyrë që procedurën përmbarrimore ta bëjnë më efektive. Po ashtu gjyqtarët civil duhet të marrin një rol më aktiv për menaxhimin e procedurës përmbarrimore. Në rastet penale, aktgjykimet penale duhet të përfshijnë datën kur ato janë nënshkruar nga gjyqtari. Së fundmi, Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) duhet të i ndihmojë në mënyrë aktive gjykatave dhe të raportojë lidhur me përputhshmërinë e tyre me dispozitat përkatëse të *Strategjisë Shtetërore për Reduktimin e Lëndëve të Vjetra*.

1. HYRJE

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Misioni në Kosovë është e brengosur se numri i madh i lëndëve përbarimore/ekzekutive që është në rritje në Kosovë, po komprometon të drejtën e palëve për gjykim brenda kohës së arsyeshme, duke shkelur në këtë mënyrë si kornizën ligjore vendore ashtu edhe ligjin ndërkombëtar për të drejtat e njeriut. Thomas Hammarberg, Komisionari për të Drejta të Njeriut pranë Këshillit të Evropës, në vitin 2009 kishte thënë se “[e]kzekutimi i mangët i vendimeve përfundimtare gjyqësore duhet të shihet si refuzim për të pranuar sundimin e ligjit dhe është një problem serioz për të drejtat e njeriut.”¹ Në raportin e vet të Progresit në Kosovë, Komisioni Evropian ka gjetur se “niveli i ulët i zbatimit të vendimeve gjyqësore është një pengesë e madhe për krijimin e besimit në gjyqësor.” Raporti nënvizon se “aktgjykimet e pa-ekzekutuara kanë shkelur besimin e publikut në aftësinë, profesionalizmin dhe korrektësinë e gjyqësorit, duke kufizuar në këtë mënyrë qasjen efektive në drejtësi”.²

Përbarimi/ekzekutimi i aktgjykimeve është po ashtu indikator i pavarësisë gjyqësore:

“Garancitë kushtetuese të ndarjes së pushteteve dhe pavarësia e gjyqësorit u lejojnë gjyqtarëve t’i mbrojnë të drejtat dhe liritë e individëve të përcaktuara me ligj. Megjithatë, këto garanci kushtetuese dhe mbrojtje ligjore humbin rëndësinë e vet atëherë kur vendimet gjyqësore nuk zbatohen. Veç kësaj, kur individëve u mungon besimi në zbatueshmërinë e vendimeve, ka gjasa që ata më pak të mbështeten në gjykata për zgjidhjen e kontesteve dhe si rezultat mund t’u kthehen mënyrave tjera jozyrtare dhe private për të kërkuar drejtësi. Me kalimin e kohës, dështimi për t’i zbatuar në mënyrë efektive vendimet do të zbeh besimin në sistemin e drejtësisë dhe sundimin e ligjit”.³

Në Kosovë, aktgjykimet si në rastet civile ashtu edhe në ato penale, pasi të marrin formën e prerë, përbarohen/ekzekutohen nga zyrtarë për përbarime në gjykata, që përfshijnë gjyqtarë dhe referentë për përbarime.⁴ Në rastet civile, procedura përbarimore inicohet nga kreditori në mënyrë që të fitojë gëzimin e së drejtës e cila veç se i është njohur në aktgjykim të formës së prerë apo në ndonjë tjetër dokument origjinal. Në rastet penale, ekzekutimi i sanksioneve penale fillon me automatizëm sapo aktgjykimi me të cilin është caktuar sanksioni penal merr formën e prerë dhe nuk ka pengesa ligjore për përbarim të tij.

¹ Thomas Hammarberg, Komisionar për të Drejtat e Njeriut në Këshillin e Evropës; *Zbatimi me të Meta i Vendimeve Gjyqësore Zbeh Besimin në Drejtësinë e Shtetit*; 31 gusht 2009. Në dispozicion në Internet përmes faqes http://www.coe.int/t/commissioner/Viewpoints/090831_en.asp (e qasur me 27 shtator 2011).

² Komisioni Evropian, *Raporti i Progresit për Kosovën* për vitin 2010*, (*nën Rezolutën e KSKB-ve, 1244/1999), SEC(2010) 1329, Bruksel, 9 nëntor 2010, që i bashkëngjitet *Komunikatës nga Komisioni për Parlamentin Evropian dhe Këshillin për Strategjinë e Zgjerimit dhe Sfidat Kryesore 2010-2011*, COM(2010) 660, faqe 11.

³ ABA-CEELI, *Analiza e Kornizave Legjislative për Përbarimin e Vendimeve*, CEELI Koleksioni i Letrave nga Hulumtimi, Uashington, D.C., korrik 2003, fq. 1.

⁴ Regjimet e ndryshme lidhur me përcaktimin e personelit për përbarime civile e penale do të detajohen më vonë në raport.

Sipas statistikave të publikuara nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), ka pasur një numër të përgjithshëm prej 89,201 të aktgjykimeve civile në pritje të përmbarimit në gjykatat komunale në Kosovë deri në dhjetor të vitit 2009. Gjatë rrjedhës së periudhës dymbëdhjetë-mujore në vijim, 26,568 lëndë përmbarimore civile u futën në sistem përderisa gjykatat kompletuan përgjithësisht 10,992 lëndë, duke rezultuar më një numër të përgjithshëm prej 104,777 lëndë civile të pa përmbaruara deri nga fundi i dhjetorit të vitit 2010. Kjo përfaqëson një rritje neto prej 15,576 të lëndëve gjatë kalimit të vitit, ose përafërsisht 17.46%. Andaj, në vitin 2010 gjykatat civile në përgjithësi kanë përfunduar përafërsisht 9.49% të numrit total prej 115,769 rasteve që ndodheshin pranë tyre gjatë vitit.

Numrat në anën penale të përlllogaritjes, edhe pse shumë më të vegjël ende janë mjaft domethënëse. Sipas statistikave të KGJK-së, ka pasur një numër të përgjithshëm prej 12,858 aktgjykimesh penale në gjykatat komunale në Kosovë nga fundi i dhjetorit të vitit 2009. Gjatë rrjedhës së periudhës pasuese dymbëdhjetë-mujore, 6,222 lëndë ekzekutive penale u futën në sistem përderisa gjykatat kompletuan përgjithësisht 5,651 lëndë, duke rezultuar në një numër të përgjithshëm prej 13,429 lëndë penale të pa-ekzekutuara deri nga fundi i dhjetorit të vitit 2010. Intervistat e kryera nga OSBE me referentët për ekzekutime zbulojnë së shumica dërmuese e këtyre aktgjykimeve parashohin gjoba monetare. Kjo ka qenë një rritje neto prej 571 të lëndëve gjatë kalimit të vitit, ose përafërsisht 4.44%. Andaj, në vitin 2010 gjykatat penale në përgjithësi kanë përfunduar përafërsisht 29.62% të numrit total prej 19,080 rasteve që ndodheshin pranë tyre gjatë vitit.⁵

E drejta për përmbarim të aktgjykimit është një pjesë integrale e së drejtës për gjykim të drejtë brenda kohës së arsyeshme. Ky raport, shqyrton kornizën ligjore si në vend ashtu edhe atë ndërkombëtare të zbatueshme për përmbarimin e aktgjykimeve civile dhe penale; raporti po ashtu shqyrton dispozitat e Strategjisë për Reduktimin e Lëndëve të Vjetra⁶ të paraqitura nga KGJK-ja në nëntor të vitit 2010 dhe zbatimin e saj të deritashëm nga ana e gjykatave. Raporti më tej vazhdon të shqyrtojë praktikën përmbarimore civile nga gjykatat në Kosovë; nënvizon gjetjet për dy lloje të rasteve përmbarimore civile: ato që përfshijnë mbledhjen e faturave të papaguara për shërbime komunale dhe ato që përfshijnë subjekte publike si debitorë të aktgjykimeve. Raporti po ashtu nënvizon mangësitë në procesin e ekzekutimit të sanksioneve penale ndaj personave të dënuar për krime në Kosovë.

Raporti përfundon me një numër rekomandimesh për Parlamentin e Kosovës, kryetarët e gjykatave dhe gjyqtarët, Institutin Gjyqësor të Kosovës (IGJK) dhe KGJK-në, që kanë për qëllim korrigjimin e mangësive të vërejtura në procedurën

⁵ Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK), Departamenti i Statistikës; *Raporti-2010: Statistika e gjykatave të rregullta*, faqe 18. E qasshme në Internet në http://www.kgjk-ks.org/repository/docs/RAPORTI_VJETOR_Pergjithshm_2010_SHQIP_879988.pdf (e qasur më 27 shtator 2011).

⁶ Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), Strategjia për Reduktimin e Lëndëve të Vjetra, i publikuar me 11 nëntor 2010 në bazë të Ligjit Nr. 03/L-122, mbi Përbërjen e Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Rregullores nr 2005/52 mbi Themelimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, bazuar në Planin Strategjik të Gjyqësisë në Kosovë për periudhën 2007-2012. http://drejtesia-ks.org/repository/docs/Strategjia_shteterore_per_Zvogelimin_e_Lendeve_-_Shqip.pdf. (e qasur më 27 shtator 2011).

përmbartimore/ekzekutive civile dhe penale dhe në këtë mënyrë të zvogëlojnë numrin e madh të rasteve të pazgjidhura përmbartimore/ekzekutive.⁷

2. KORNIZA LIGJORE

A) Standardet Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut⁸

Neni 6(1) i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Fundamentale (KEDNJ) parasheh se, në përcaktimin e “të drejtave dhe obligimeve civile të tij apo të saj, çdokush ka të drejtën për dëgjim korrekt dhe publik brenda kohës së arsyeshme nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e themeluar sipas ligjit.”⁹

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNJ) e cila gjykon çështjet ligjore që dalin nga rastet vendore dhe që përfshijnë si çështje penale ashtu edhe civile, ka gjetur se procedurat përmbartimore/ekzekutive duhet të shihen si “pjesë integrale e ‘gjykimit’ për qëllime të Nenet 6”.¹⁰ Gjykata gjeti se e drejta për gjykim korrekt do të ishte:

“iluzore nëse një [...] sistem gjyqësor vendor do të lejonte që një vendim final gjyqësor i formës së prerë të mbetet jo-funksional në dëm të njëres palë. Do të ishte e pakuptimtë që Neni 6[1] të përshkruante në detaje garancitë procedurale që i sigurohen palëve gjyqësore – procedurat që janë të drejta, publike dhe ekspeditive – pa mbrojtur zbatimin e vendimeve gjyqësore; që Neni 6 të interpretohet që ka të bëjë ekskluzivisht me qasjen në gjykatë dhe zhvillimin e procedurave, ka gjasa që do të qonte në situata që nuk do të ishin në pajtueshmëri me sundimin e ligjit.”¹¹

Në rastin e cituar më sipër, GjEDNJ ka gjetur se, kur gjykata vendore është përmbajtur për më shumë se pesë vite nga “marrja e masave të nevojshme për të zbatuar një vendim gjyqësor të formës së prerë”, institucionet relevante kanë cenuar

⁷ OSBE ka raportuar më parë mbi mangësitë lidhur me përmbartimet e vendimeve civile në Kosovë. Shih raportin e OSBE-së, *Kosovo: Shqyrtimi i parë i Sistemit të Drejtësisë Civile*; qershor 2006, faqet 46-49. E qasshme në Internet në <http://www.osce.org/sq/kosovo/19402> (e qasur më 25 korrik 2011) dhe raporti i OSBE-së, *Vonesat në ekzekutimin e vendimeve të përfundimtare të gjykatave paraqesin shkelje të ligjit vendor dhe të drejtën për një gjykim korrekt*; shtator 2007, faqe 3-4. E qasshme në Internet në <http://www.osce.org/sq/kosovo/28298> (e qasur më 25 korrik 2011).

⁸ Tetë standarde të numëruara të të drejtave të njeriut ndërkombëtare, përfshirë edhe Konventën Evropiane për Mbrojtjen e Të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Fundamentale (KEDNJ), Këshilli i Evropës, së bashku me praktikën gjyqësore në bazë të secilës prej tetë standardeve, janë drejtpërdrejtë të aplikueshme në Kosovë, dhe në rast konflikti, kanë prioritet sipër ligjit të Kosovës: shih Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 1999/24 mbi Ligjin e Aplikueshëm në Kosovë, neni 1.3(b), Rregulloren e UNMIK-ut 2001/9 mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, Neni 3.2(b) dhe Nenet 22(2) dhe 53 të kushtetutës së Kosovës të vitit 2008.

⁹ Shih Nenin 6(1), KEDNJ ETS 5, 4 nëntor 1950, hyri në fuqi me 3 shtator 1953.

¹⁰ *Hornsby kundër Greqisë*, aktgjykimi i GjEDNJ-së i 19 marsit 1997, paragrafi 40. Shih po ashtu *Burdov kundër Rusisë*, aktgjykimi i GjEDNJ-së i 7 majit 2002, paragrafët. 33-38.

¹¹ Ibid.

dispozitat e Nenit 6[1] “nga të gjitha efektet e dobishme” dhe duke e bërë këtë kanë shkelur të drejtën e paditësit për gjykim korrekt.¹²

Në vitin 2003, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës (Komiteti) ka lëshuar një Rekomandim mbi zbatimin e aktgjykimeve civile dhe penale.¹³ Në Rekomandimin e vet, Komiteti vuri në dukje se autoritetet “kanë për detyrë të sigurojnë që të gjithë personat që marrin aktgjykim përfundimtar të formës së prerë të kenë të drejtën për zbatim të tij”. Komiteti më tej nënvizoi “trezikun që pa një sistem efektiv të zbatimit, mund të vijë në shprehje forma tjera të ‘drejtësisë private’ dhe ato të kenë pasojë negative në sigurinë e publikut në sistemin juridik dhe besueshmërinë e tij”.¹⁴ Veç kësaj, duke theksuar rëndësinë e përmbarimit me kohë të aktgjykimeve në rastet penale, Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë rekomandon që të sigurohet zbatimi i dënimeve si mënyrë për të “përmirësuar besimin në sistemin e drejtësisë penale dhe për të zvogëluar krimin”.¹⁵

Në vitin 2010, Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropian (KKGJE) lëshoi një Mendim (2010) mbi Rolin e Gjyqtarëve në Zbatimin e Vendimeve Gjyqësore.¹⁶ Në Mendimin e vet, KKGJE vuri në dukje se:

“zbatimi efektiv i një vendimi gjyqësor përfundimtar është një element fundamental i sundimit të ligjit. Është qenësore për të siguruar besimin e publikut në autoritetin e gjyqësorit. Pavarësia gjyqësore dhe e drejta për gjykim të drejtë (Neni 6 i KEDNJ-së) janë më kot po që se vendimi nuk zbatohet”.¹⁷

Duke trajtuar në veçanti rolin e gjyqtarëve në zbatimin e vendimeve në procedurat civile, KKGJE është e mendimit se zbatimi i vendimit nuk do të duhej “të kërkojë fillimin e procedurës krejtësisht të re” dhe se procedurat e zbatimit do të duhej “të mos lejojnë ri-hapjen e meritave të vendimeve gjyqësore origjinale.” Megjithatë, vë në dukje atë se gjyqtari mund të mbajë “fuqinë që ta suspendojë apo shtyjë zbatimin për të marrë në konsideratë rrethanat e veçanta të palëve ndërgjyqëse, për shembull

¹² Ibid, paragraf 45.

¹³ *Rekomandimi (2003)17 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare mbi zbatimin*, e lëshuar në bazë të Nenit 15. b të Statutit të Këshillit të Evropës, e adoptuar nga Komiteti i Ministrave me 9 shtator 2003 në mbledhjen e 851^{te} të Zëvendës Ministrave. <https://wcd.coe.int/wcd/ViewDoc.jsp?id=65531&Site=COE> (e qasur më 25 korrik 2011).

¹⁴ Ibid, paragrafët preambulë.

¹⁵ *Përdoruesit e sistemit të drejtësisë vis-à-vis ngadalësisë së drejtësisë: si të përmirësohet? Dy situata simbolike*, e publikuar nga grupi punues nr. 2 të Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë, Strasburg 17 shtator 2003 [https://wcd.coe.int/wcd/ViewDoc.jsp?Ref=CEPEJ\(2003\)21&Sector=secDGHL&Language=lanEnglish&Ver=original&BackColorInternet=eff2fa&BackColorIntranet=eff2fa&BackColorLogged=c1cbe6](https://wcd.coe.int/wcd/ViewDoc.jsp?Ref=CEPEJ(2003)21&Sector=secDGHL&Language=lanEnglish&Ver=original&BackColorInternet=eff2fa&BackColorIntranet=eff2fa&BackColorLogged=c1cbe6) (e qasur më 25 korrik 2011).

¹⁶ Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropian (KKGJE), Mendimi Nr. 13 (2010) mbi Rolin e Gjyqtarëve në Zbatimin e Vendimeve Gjyqësore, KKGJE 2010(2) Final, Strasburg, 19 nëntor 2010. [https://wcd.coe.int/wcd/ViewDoc.jsp?Ref=CCJE\(2010\)2&Language=lanEnglish&Ver=original&BackColorInternet=DBDCF2&BackColorIntranet=FDC864&BackColorLogged=FDC864](https://wcd.coe.int/wcd/ViewDoc.jsp?Ref=CCJE(2010)2&Language=lanEnglish&Ver=original&BackColorInternet=DBDCF2&BackColorIntranet=FDC864&BackColorLogged=FDC864) (e qasur më 25 korrik 2011)

¹⁷ KKGJE, Mendimi Nr. 13 (2010) mbi Rolin e Gjyqtarëve në Zbatimin e Vendimeve Gjyqësore, KKGJE 2010(2) FINAL, Seksioni III. Roli i gjyqtarëve në zbatimin e vendimeve gjyqësore në çështjet civile, e lëshuar në Strasburg me 19 nëntor 2010.

për t'i dhënë efekt Nenet 8 të KEDNJ-së".¹⁸ Së fundmi, KKGJE nënvizon se në qoftë se:

“duhet të ruhet sundimi i ligjit si dhe duhet të sigurohet besimi i palëve në sistemin e drejtësisë, veprimet e zbatimit duhen të jenë proporcionale, të drejta dhe efektive. Për shembull, gjetja dhe mbledhja e aseteve të të pandehurit duhet të bëhet në mënyrën më efektive të mundshme derisa mbahen parasysh dispozitat e aplikueshme për të drejtat e njeriut, mbrojtja e të dhënave personale dhe nevoja për shqyrtim gjyqësor”.¹⁹

KKGJE rekomandon që “Këshilli i Gjyqësorit, ose ndonjë tjetër organ i pavarur përkatës, rregullisht të publikojë raport mbi efikasitetin e zbatimit duke përfshirë të dhëna për vonesa dhe shkaqet e tyre si dhe për metoda të ndryshme zbatimi. Një pjesë e veçantë do të duhej të trajtojë zbatimin e vendimeve gjyqësore ndaj subjekteve publike”.²⁰

B) Ligji Vendor

Legjislacioni civil

Procedurat përbarimore civile në Kosovë rregullohen përmes Ligjit për Procedurën Përbarimore,²¹ përpos në raste kur parashihet ndonjë tjetër ligj i veçantë.²² Ky ligj parashih procedurën përbarimore të mbikëqyrur nga një gjyqtar i caktuar përbarimor dhe të zbatuar nga referentët e gjykatës të caktuar për përbarime, me ndihmën e policisë së Kosovës kur kjo është e nevojshme.²³ Ligji po ashtu parashih procedurë të përsheptuar; parashih se gjykata ka për detyrë të “veprojë me ngutshmëri” në rastet përbarimore.²⁴ Veç kësaj, parashih se gjykata duhet të procedojë rastet përbarimore sipas radhës që i ka pranuar, përpos kur “natyra e kredisë ose rrethanat e posaçme kërkojnë që gjykata të veprojë ndryshe”.²⁵

Sipas Ligjit për Procedurën Përbarimore, vendimi për përbarim nuk bëhet i përbarueshëm derisa të jenë shterur, apo të ketë skaduar afati për të gjitha

¹⁸ Ibid, paragrafi 24. Neni 8 mbron të drejtën për respektim të jetës private dhe familjare. KKGJ nënvizon paragrafin 8 se procedurat përbarimore “duhet të zbatohen në pajtueshmëri me të drejtat dhe liritë fundamentale” përfshirë edhe ato të artikuluar në Nenin 8.

¹⁹ Ibid, paragrafi 25.

²⁰ Ibid, paragrafi 23.

²¹ Neni 1(1), Ligji Nr. 03/L-008 për Procedurën Përbarimore, 15 korrik 2008. Ky ligj po ashtu rregullon përbarimin e vendimeve në rastet gjyqësore administrative dhe përbarimin e rasteve të kundërvajtjeve që përfshijnë pagesa të parave: Neni 1(2).

²² Dy ligje që parashohin ndryshe janë Ligji Nr. 03/L-182 për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, 10 gusht 2010, dhe Ligji Nr. 02/L-17 për Shërbimet Sociale dhe Familjare, i shpallur përmes Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2005/46, 14 tetor 2005. Ligji për Mbrojtje nga Dhuna në Familje parashih një regjim sipas të cilit urdhrat për mbrojtje lëshohen nga gjykatat komunale por përbarohen, kur kjo është e nevojshme, nga policia e Kosovës; shih Nenet 3 dhe 18-20. Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare trajton përbarimin e disa urdhrave. Parashih ndihmën e policisë së Kosovës në përbarimin e urdhrave për kujdestari ku përfshihen të rriturit e rrezikuar; po ashtu mbulon edhe përbarimin e urdhrave mbrojtës që përfshijnë të rritur të tillë nga ana e Nënpunësit e Shërbimeve Sociale të punësuar pranë Qendrave për Punë Sociale.

²³ Kreu IV, Ligji për Procedurën Përbarimore. Shih po ashtu Nenet 2 dhe 9. Lidhur me ndihmën nga policia e Kosovës, shih Nenin 267.

²⁴ Neni 5, Ibid.

²⁵ Ibid.

kundërshtimet.²⁶ Vetëm kur ndaj vendimit për përmbarim nuk ka pasur kundërshtime apo ankesa brenda periudhës kufizuese të aplikueshme, ose kur të gjitha vërejtjet dhe ankesat e mundshme të jenë shterur, ai do të bëhet “i formës së prerë dhe i përmbarueshëm”.²⁷ Vendimi i tillë merr formë të prerë kur ankesa nuk është e lejuar me ligj, ka skaduar afati për të apo është refuzuar.²⁸

E drejta për “gjykim të drejtë dhe të paanshëm” është e përfshirë në kornizën ligjore të Kosovës.²⁹ Në një aktgjykim të lëshuar kohëve të fundit, Gjykata kushtetuese e Kosovës përsëriti praktikën gjyqësore të lartë-përmendur të GjENDJ-së kur pohoi se e drejta për të filluar procedurën pranë gjykatës për çështje civile, do të ishte iluzore “nëse sistemi ligjor i Kosovës do të lejonte një vendim gjyqësor përfundimtar dhe të plotfuqishëm që të mbetej i paefektshëm në dëm të një pale”.³⁰

Rasti pranë gjykatës kushtetuese i cituar më sipër, përfshinte përpjekjet ligjore të ndërmarra përgjatë shumë viteve nga 912 parashtruesit e padisë, ish-punëtorë të një ndërmarrjeje në pronësi shoqërore e cila më pas ishte privatizuar, për kthimin e pagave që ata kishin humbur si rezultat i shkarkimit të tyre jo-ligjor nga puna.³¹ Parashtruesit e kërkesës kishin pranuar një aktgjykim përfundimtar nga gjykata komunale e Ferizaj/Uroševac më 11 janar të viti 2002; megjithatë, aktgjykimi mbeti i papërmbaruar për gati nëntë vite pasi që kishte marr formën e prerë. Parashtruesit e kërkesës argumentonin se aktgjykimi i vitit 2002 ishte bërë *res judicata*³² dhe ata kishin të drejtën në përmbarimin e tij.

Gjykata vendosi në favor të parashtruesve të kërkesës, duke pohuar se e drejta për gjykim të drejtë dhe efektiv, siç është garantuar si me kushtetutë ashtu edhe me KEDNJ ishte shkelur me dështimin për të përmbaruar aktgjykimin. Gjykata gjeti se:

“sundimi i ligjit është një prej parimeve themelore të një shoqërie demokratike, presupozon respektimin e parimit të sigurisë juridike, sidomos në lidhje me vendimet gjyqësore që kanë marrë formën *res judicata*. Asnjë palë nuk ka të drejtë të kërkojë rishikimin e një aktgjykimi përfundimtar dhe të plotfuqishëm thjesht për qëllimin e fitimit të rishikimit dhe rishqyrtimit të

²⁶ Neni 12.6 dhe Neni 13, Ligji për Procedurën Përmbarimore. Ligji Nr. 2004/32 për Familjen, i shpallur përmes Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/7, 16 shkurt 2006, parasheh dy përjashtime të këtij rregulli, i pari ka të bëjë me vendimet për “masa të përkohshme për sigurimin e mbajtjes financiare për bashkëshortin dhe vendosjen e tij” (Neni 71) dhe i dyti ka të bëjë me vendimet që lidhen me “masa të përkohshme për mbrojtjen, edukimin dhe vendosjen e fëmijës” (Neni 344). Ankesa për vendime të tilla nuk do ta ndalojë përmbarimin e tyre.

²⁷ Neni 13, Ligji për Procedurën Përmbarimore.

²⁸ Neni 13.2 dhe 13.3, Ligji për Procedurën Përmbarimore.

²⁹ Neni 31, kushtetuta e Kosovës e miratuar me 9 prill 2008, hyri në fuqi me 15 qershor 2008. Shih po ashtu Kreun 3, Rregullorja e UNMIK-ut 2001/9 mbi Kornizën Kushtetuese të Vetëqeverisjes së Përkohshme në Kosovë, e miratuar me 10 qershor 2001.

³⁰ Gjykata kushtetuese e Kosovës, Aktgjykimi (Nr. Ref AGJ 75/10) i lëshuar në Prishtinë/Priştina me 17 dhjetor 2010, në Rastin Nr. KI 08/09, *Sindikata e Pavarur e Punonjësve të Fabrikës së Çelikut IMK Ferizaj*, vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të gjykatës komunale në Ferizaj/Uroševac, *Aktivendimi C. Dr. 340/2001, i datës 11 janar 2002, paragrafi 61*.

³¹ Gjykata komunale në Ferizaj/Uroševac, në *Vendimin C Nr. 340/2011, të datës 11 janar 2002*, dha arsyetimin se shkarkimi ka qenë i paligjshëm pasi që përderisa punësimi i paditësve është ndërprerë për shkak të mungesës në punë, në fakt paditësit kishin munguar për shkak se atyre nuk ju është lejuar të shkojnë në punë.

³² *Res judicata* është një çështje që është vendosur përfundimisht përmes vendimit gjyqësor. Shih Fjalorin “Black’s Law” Edicionin e Tetë, (Shtetet e Bashkuara, Thomson West, 2004) fq. 1336.

freskët të rastit [...] Po të mos ishte kështu, kthimi prapa i vendimeve përfundimtare do të çonte në një klimë të përgjithshme të pasigurisë juridike, duke zvogëluar kështu besimin publik në sistemin gjyqësor, si dhe rrjedhimisht edhe në sundimin e ligjit. Autoritetet kompetente, pra, kanë obligimin pozitiv që të organizojnë një sistem për zbatimin e vendimeve, i cili është efektiv edhe në kuptimin ligjor edhe në atë praktik, si dhe i cili siguron zbatimin e tyre pa vonesa të panevojshme.

Për mendimin e Gjykatës, ekzekutimi i një aktgjykimi të marrë nga një gjykatë duhet shikuar si pjesë përbërëse e të drejtës për gjykim të drejtë [...] Në rastin konkret, parashtresit nuk do të duheshin privuar nga përfitimi i vendimit, i cili kishte marrë formë *res judicata*, në favorin e tyre”.³³

Gjykata përfundoi se me dështimin për të përmbuar aktgjykimin për një periudhë kaq të gjatë kohore “autoritetet e duhura i kanë privuar dispozitave të Nenit 31 të kushtetutës dhe Neneve 6 dhe 13 të KEDNJ-së, gjithë efektin e tyre të dobishëm”.³⁴

Legjislacioni Penal

E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm zbatohet si në gjykimet civile ashtu edhe penale³⁵. Procedura penale ekzekutive në Kosovë është e rregulluar me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës³⁶ dhe Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.³⁷

Aktgjykimi në gjykatën penale të shkallës së parë shpallet nga kryetari i trupit gjykues menjëherë pasi të merret nga gjykata.³⁸ Kësaj shpalljeje verbale i pason aktgjykimi me shkrim. Aktgjykimi duhet “të përpilohet me shkrim brenda pesëmbëdhjetë ditë nga shpallja e tij kur i akuzuari gjendet në paraburgim, ndërsa brenda tridhjetë ditë në rastet tjera”.³⁹

Aktgjykimet penale mund të ekzekutohen vetëm kur “kur është bërë dorëzimi dhe kur për ekzekutimin e tij nuk ka pengesa ligjore”.⁴⁰ Një pengesë ligjore për ekzekutim është se aktgjykimi nuk merr formë të prerë deri kur “nuk mund të kundërshtohet me ankesë ose kur nuk lejohet ankesë”.⁴¹ Është në këtë fazë procedurale, në pikën e aktgjykimit përfundimtar, kur i pandehuri definohet si “person i dënuar”⁴² dhe sanksioni ndaj tij mund të caktohet.

³³ Ibid, paragrafët 62-63.

³⁴ Ibid, paragrafi 64.

³⁵ Shih fusnotën 28.

³⁶ Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale të Kosovës, i shpallur përmes Rregullores së UNMIK-ut 2003/26, 6 korrik 2003, me ndryshimet pasuese. Me 27 nëntor 2008, Kosova shpalli Ligjin Nr. 03/L-003 mbi Ndryshimin dhe Plotësimin e Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës Nr 2003/26, që la kodin përmbajtësish të njëjtë me ligjin e vitit 2003, edhe pse një pjesë për aranzhimet lidhur me deklarimin e fajësisë ishte shtuar, një nen mbi kohëzgjatjen e paraburgimit policor ishte ndryshuar dhe emri i ligjit ishte ndryshuar në Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, prej këtu e tutje KPPK.

³⁷ Ligji Nr. 03/L – 191 mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, 22 korrik 2010.

³⁸ Neni 392(1), KPPK.

³⁹ Neni 395(1), KPPK.

⁴⁰ Neni 135(2), KPPK.

⁴¹ Neni 135(1), KPPK.

⁴² Neni 151(4), KPPK.

C) Zhvillimet e Fundit në Kornizën Normative

Në nëntor të vitit 2010, KGJK publikoi *Strategjinë Shtetërore për Reduktimin e Lëndëve të Vjetra* (Strategjia). Strategjia është hartuar me qëllim të trajtimit të lëndëve të pakryera civile, penale dhe përmbare, dhe përmban një numër pikash veprimi që trajtojnë në mënyrë specifike përmbaremin e aktgjykimeve civile dhe penale. Përkitazi me lëndët përmbare civile këto përfshijnë nënshkrimin e memorandumit të mirëkuptimit (MiM) ndërmjet KGJK-së dhe Policisë së Kosovës,⁴³ bankës qendrore⁴⁴ dhe zyrës për regjistrimin e bizneseve.⁴⁵ Strategjia parasheh se KGJK brenda dy viteve nga publikimi i Strategjisë do të lëshojë një vendim lidhur me “organizimin e sistemit për përmbare në të ardhmen (gjyqësor, publik, privat, etj)”.⁴⁶ Nga kryetarët e gjykatave është kërkuar që brenda dy jave pas lëshimit të Strategjisë, të caktojnë nga një grup punues në kuadër të secilës gjykatë për të trajtuar “zvogëlimin e lëndëve të vjetra të ekzekutimeve (penale/civile) në çdo gjykatë komunale dhe në gjykatën ekonomike”.⁴⁷ Strategjia parasheh që grupi punues do të nis menjëherë “inventarizimin elektronik” dhe “kategorizimin” e të gjitha lëndëve përmbare civile dhe penale⁴⁸ dhe “caktimin e afateve kohore për procedimin e lëndëve (sipas kategorive)”.⁴⁹ Strategjia gjithashtu e parasheh një ndryshim në Ligjin e Procedurës Përmbare për të kaluar obligimin e sigurimit të adresës së debitorit nga gjykata tek kreditori.⁵⁰ Në lidhje me rastet e përmbareve penale Strategjia parasheh krijimin e një inventari të rasteve përmbare penale, ku qartazi do të paraqiten afatet e zbatueshme kufizuese për secilin rast.⁵¹ Në fund, Strategjia parasheh përdorim më të gjerë të marrëveshjeve rreth fajësisë dhe procedurave të ndërmjetësimit, të cilat, në rast se zbatohen në mënyrë sistematike do të ndihmojnë në uljen e rasteve përmbare penale që do të i shtohen sistemit në të ardhmen.⁵²

Dispozitat e Strategjisë lidhur me rastet civile përmbare, po që se zbatohen plotësisht do duhej të ishin të mjaftueshme për të pasur efekt në zvogëlimin e numrit

⁴³ Strategjia, fq. 9, pika 7.a. Ky MiM do të “rregullojë bashkëpunimin në mes të palëve [së MiM] për ndihmë më efektive dhe më shpejtë të policisë p.sh. asistencë në teren, vërtetimi i adresës etj”.

⁴⁴ Strategjia, fq. 3, pika 2.f. Ky MiM “do të rregullojë bashkëpunimin lidhur me identifikimin dhe bllokimin e xhirollogaritë bankare, caktimin e gjobave dhe sanksioneve të tjera për mos zbatimin e urdhërësive të gjykatës ose mos bashkëpunimin, procedimin e lëndëve të parashtruara nga bankat, etj”.

⁴⁵ Strategjia, fq. 9, pika 7.e. Ky MiM do të “rregullojë bashkëpunimin në mes [të] palëve [së MiM] në rast të çregjistrimit të bizneseve ose kërkesat për informatë lidhur me biznes që është debitor në procedurën përmbare.”

⁴⁶ Strategjia, fq. 10, pika 10. Shënimi sqarues për këtë pikë thotë: “KGJK duhet të vendos për sistemin e përmbaremit më të përshtatshëm për Kosovën.”

⁴⁷ Strategjia, fq. 20, pika 1.a. Pika 2 parasheh “identifikimi i stafit mbështetës që mund të ndihmojnë në ekzekutim si dhe lëshimi i urdhërësive së caktimit nga kryetari i gjykatës.”

⁴⁸ Strategjia, fq. 21, pika 3. Lëndët duhet të kategorizohen “sipas llojit të lëndës ose kreditorit”. Kategorizimi duhet të bëhet në “koordinim me programin SEAD.” Programi, *Sistemi për Përmbaremin e Marrëveshjeve dhe Vendimeve* [SEAD] është një program që operon në Kosovë nën patronatin e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Projekti fokusohet në përmirësimin e mundësisë së qytetarëve, bizneseve dhe sistemit gjyqësor që të përdorin dhe zbatojnë kontratat dhe obligimet, dhe të zbatojnë aktgjykimet gjyqësore në një mënyrë të drejtë dhe me kohë. <http://www.seadprogram.com> (e qasur më 8 nëntor 2011).

⁴⁹ Strategjia, fq. 21, pika 5.a.

⁵⁰ Strategjia, fq. 29, pika 1. Parashihet që ky ndryshim të bëhet “brenda vitit të parë të zbatimit” të Strategjisë.

⁵¹ Strategjia, pika 1 (b) dhe 2.

⁵² Strategjia, fq. 16, pikat 1 (a), (b) dhe (c).

të madh të atyre rasteve. Megjithatë, në një intervistë me një përfaqësues të KGJK-së mësohet se zbatimi i atyre dispozitave të Strategjisë, thënë më së miri, ka qenë i pabarabartë⁵³. Deri në fund të tetorit të vitit 2011 nuk është nënshkruar asnjëri nga MiM-et e parapara, dhe më pak se gjysma e gjykatave kanë caktuar grupet punuese të e obliguara.⁵⁴ Në mesin e gjykatave ku grupet janë caktuar, pak punë është kryer drejt inventarizimit elektronik të lëndëve, siç parashihet në Strategji.⁵⁵ Deri më sot nuk është bërë asnjë ndryshim në Ligjin e Procedurës Përmbartimore; mirëpo një draft ligj i ri i është dorëzuar Kuvendit të Kosovës.⁵⁶ Në fund, në lidhje me thirrjen që gjykatat duhet të i vënë në përdorim më të gjerë procedurat e ndërmjetësimit në rastet përmbartimore penale, OSBE-ja është njoftuar që deri në tetor të vitit 2011 ndërmjetësuesit nuk e kanë filluar punën në këtë fushë.⁵⁷

Çështje të një shqetësimi të vazhdueshëm rreth zbatimit të Strategjisë i përfshijnë mundësitë në kuadër të obligimit të gjykatës në rastet përmbartimore kur adresa ose vendndodhja e debitorit është e panjohur⁵⁸ dhe autoritetin e gjykatës *vis-à-vis* sekuestrimit të asetëve.⁵⁹ Përveç kësaj, gjykatat do të përfitonin nga një udhëzim në lidhje me rrethanat në të cilat ato do të lejoheshin të gjykonin raste përmbartimore jashtë radhe.⁶⁰ Strategjia parasheh që gjykata supreme të sigurojë sqarime në lidhje me këto çështje në formë të një qëndrimi ligjor. Kur qëndrimi i tillë ligjor të sigurohet do të i ndihmojë gjykatave në realizimin e zvogëlimit edhe më të madh të lëndëve të vjetra civile përmbartimore.

KGJK-ja në raportin e kohëve të fundit mbi “Progresin e punës së arritur nga Gjyqësori i Kosovës në zbatimin e Strategjisë Shtetërore për Reduktimin e Lëndëve të Vjetra”⁶¹, i publikuar më 28 tetor të vitit 2011 i shtjellon hollësisht hapat e ndërmarra nga KGJK-ja, gjykatat dhe partnerët tjerë me rëndësi për adresimin e çështjes së lëndëve të pakryera. Sipas raportit, “Gjyqësori i Kosovës prej 1 janarit deri më 30 shtator të vitit 2011 i ka përfunduar gjithsej 33.82% të lëndëve nga numri i përgjithshëm i lëndëve të pakryera”.⁶² Nga kjo del që ndonëse është bërë një progres i lavdërueshëm në trajtimin e lëndëve të pakryera civile, penale dhe përmbartimore në përgjithësi, zbatimi i Strategjisë në disa aspekte ka qenë i ngadalshëm dhe ngelet një proces në vijim e sipër.

3. PËRMBARIMI I AKTGJYKIMEVE CIVILE NË KOSOVË

⁵³ Përfaqësues pranë Njesisë së Auditorit Gjyqësor të KGJK-së, Prishtinë/Priština, Kosovë, intervistë personale më 11 tetor të vitit 2011.

⁵⁴ Ibid.

⁵⁵ Ibid.

⁵⁶ Faqja elektronike e Kuvendit të Kosovës, <http://www.assembly-kosova.org/?cid=2.194&filter=4>, (qasur më 8 nëntor 2011)

⁵⁷ Përfaqësues pranë Sekretariatit të Komisionit për Ndërmjetësim të Kosovës, Prishtinë/Priština, Kosovë, intervistë personale më 10 tetor të vitit 2011.

⁵⁸ Strategjia, fq. 25, pika 2.

⁵⁹ Strategjia, fq. 25, pika 3. Në sqarimin për këtë pikë thuhet: “me qëllim të unifikimit të praktikave të gjykatave të ndryshme në lidhje me sekuestrimin e kolateralit të tjetërsuar gjykata supreme duhet të merr një qëndrim ligjor për të u sqaruar gjykatave se si të veprojnë në raste të tilla.”

⁶⁰ Strategjia, fq. 25, pika 5.

⁶¹ KGJK, Raporti nr. 3/8, 2011 (1 korrik – 30 shtator 2011)

⁶² Ibid, fq. 4.

Nga 104,777 raste përbarimore civile të pazgjidhura në sistem nga fundi i vitit 2010, numri më i madh 47,509, ose 45% të rasteve të përgjithshme – janë në rajonin e Prishtinës/Priştina. Rajoni i Pejës/Peć ka numrin e dytë më të madh prej 30,155, ose 29% të numrit të përgjithshëm. Rajoni i Prizrenit është në vendin e tretë, me numër të përgjithshëm prej 16,381, ose 16% të rasteve përbarimore civile të pazgjidhura. Vendi i katërt dhe i pestë mbahen respektivisht nga rajoni i Gjilan/Gnjilane, me 8448 raste, ose 8% të numrit të përgjithshëm, dhe rajoni i Mitrovicës/Mitrovica me 2,284, ose 2% të numrit të përgjithshëm të rasteve përbarimore civile të pazgjidhura në Kosovë.⁶³

Në shumicën e gjykatave komunale, një ose dy gjyqtarë janë përgjegjës për trajtimin e ngarkesës me lëndë civile përbarimore.⁶⁴ Gjyqtarëve përbarimor u ndihmojnë në punë një apo më shumë referentë të gjykatës të caktuar për përbarime, edhe pse numri i këtyre referentëve ndryshon në masë të madhe nga njëra gjykatë në tjetrën. Ndërmjet dhjetorit 2010 dhe shkurtit 2011, OSBE ka intervistuar gjyqtarë dhe referentë përbarimor në 22 gjykata komunale funksionale në Kosovë⁶⁵ për të marrë informacion lidhur me procedurat përbarimore. Shumica e gjyqtarëve përbarimor raportuan se ngarkesa e madhe me lëndë civile përbarimore ka krijuar për ta situatë pune të ‘keqe’, ‘shumë të keqe’ ose ‘shumë të vështirë’; gjyqtarët në dy gjykata komunale përdorën termin ‘katastrofë’ për ta përshkruar situatën *vis-à-vis* ngarkesës më lëndë.

Kur nga ata është kërkuar të numërojnë pengesën apo pengesat më të mëdha në punën e tyre, si gjyqtarët ashtu edhe referentët përbarimor thanë se numri i lëndëve që u janë caktuar atyre është jashtëzakonisht i madh. Që të dy anët ishin të mendimit se do të duhej të punësohej një numër më i madh referentësh përbarimor në mënyrë që barra më lëndë të trajtohet në mënyrë të duhur. Veç kësaj, gjyqtarët dhe referentët e rinj identifikuan mungesën e trajnimit specifik për procedurat përbarimore dhe mungesën e përvojës me lëndë përbarimore, si pengesë në kryerjen efektive të detyrave të tyre. Referentët përbarimor po ashtu tërhoqën vërejtjen lidhur me mungesë të hapësirës adekuate për punë, telefonave dhe pajisjeve të teknologjisë informative. Gjyqtarët dhe referentët në shumicën e gjykatave gjithashtu përmendën se adresat e pasakta të debitorëve, veçanërisht në rastet lidhur me faturat për shërbime komunale, paraqesin problem të madh. Një numër i të intervistuarve identifikuan mungesën e veturës për përbarime dhe mungesën e hapësirave për ruajtje për sendet e konfiskuara nga debitorët, si pengesa në përbarimin e aktgjyqimeve.

Rastet që përfshijnë faturat e papaguara për shërbime komunale përbëjnë shumicën e rasteve civile përbarimore në secilin rajon në Kosovë. Në rajonin e Gjilan/Gnjilane, rastet e tilla përbëjnë 60% të numrit të përgjithshëm të rasteve civile përbarimore; Në rajonin e Prizrenit ato përbëjnë 55%. Në rajonin e Pejës/Peć, 70% i numrit të përgjithshëm të rasteve civile përbarimore përfshijnë faturat e papaguara për shërbime komunale dhe rajoni i Prishtinës/Priştina, që ka më shumë raste civile përbarimore të pazgjidhura se katër rajonet e tjera të Kosovës në kombinim, 65%

⁶³ KGJK, *Raporti për vitin 2010: Statistika për Gjykatat e Rregullta*, faqe 18, fusnota e sipërme, 4.

⁶⁴ Përjashtim është rajoni i Prizrenit, ku një gjykatë komunale ka pesë gjyqtarë civil përbarimor dhe gjykata e dytë komunale ka katër. Gjykata e tretë komunale ka tre gjyqtarë përbarimor.

⁶⁵ Dy nga pesë gjykatat komunale në rajonin e Mitrovicës/Mitrovica – Zubin Potoku dhe Leposavić/Leposaviq – aktualisht nuk janë duke funksionuar; gjykatat e tretë komunale e Mitrovicës/Mitrovica – funksionon në kapacitet të kufizuar por nuk trajton rastet përbarimore.

përfshijnë aktgjykime lidhur me fatura të papaguara për shërbime komunale. Nga 104,777 të rasteve civile përmbareme që kanë mbetur të pazgjidhura deri nga fundi i vitit 2010, përafërsisht 65,000 dolën nga aktgjykimet për faturat e papaguara për shërbime komunale.⁶⁶ Dy shembujt e rasteve në vijim janë tipike nga to, të cilat janë monitoruar nga monitoruesit e gjykatave pranë OSBE-së.

Kreditori parashtrori kërkesë pranë gjykatës për të lëshuar një urdhër me të cilin do të kërkonte nga debitori që ta paguajë shumën prej 679.68 Eurove brenda tetë ditëve. Gjykata aprovoi propozimin e kreditorit dhe dërgoi vendimin te debitori në adresën e ofruar nga kreditori. Vendimi i ishte kthyer gjykatës pasi që doli se adresa ishte e pasaktë. Gjykata urdhëroi kreditorin që ta ofrojë adresën e saktë brenda shtatë ditëve dhe dështimi për ta bërë këtë do të konsiderohej si tërheqje nga propozimi për përmbareme. Kreditori nuk i ka ofruar gjykatës adresën e saktë brenda shtatë ditësh siç ishte urdhëruar.

Kreditori parashtrori, pranë një gjykate komunale kërkesë për një urdhër me të cilin do të kërkohej nga debitori që të paguajë shumën prej 2,590.97 Eurove brenda shtatë ditëve. Gjykata aprovoi propozimin e kreditorit dhe dërgoi vendimin te debitori në adresën e ofruar nga kreditori. Vendimi i ishte kthyer gjykatës pasi që doli se adresa ishte e pasaktë. Gjykata urdhëroi kreditorin që ta ofrojë adresën e saktë brenda shtatë ditëve dhe dështimi për ta bërë këtë do të konsiderohej si tërheqje nga propozimi për përmbareme. Kreditori nuk i ka ofruar gjykatës adresën e saktë brenda shtatë ditësh siç ishte urdhëruar.

Më pastaj këto raste janë konsideruar si të tërhequra nga ana e kreditorit. Për të realizuar pagesën procesi i përmbaremit duhet të filloj sërish me paraqitjen e propozimit të ri. OSBE ka vërejtur se ka një numër të madh rastesh të ngjashme me këto shembujt e rasteve të ilustruara më sipër, të gjitha prej të cilave përfshijnë Post Telekomunikacionin e Kosovës, Korporatën Elektro-energjetike të Kosovës dhe ofruesit tjerë të shërbimeve publike si kreditorë të aktgjykimeve. Veç kësaj OSBE ka vënë re që kreditorët shpesh parashtrorin propozime për përmbareme që përfshijnë adresa të pasakta të debitorëve. Këto lloje të gabimeve pa nevojë pengojnë përpjekjet e gjykatave për të përmbareme aktgjykimin, dhe komplikohen më tej me dështimin e kreditorëve për të ju përgjigjur kërkesave të gjykatës për t'i korrigjuar ato. Në një sistem gjyqësor veçse të mbingarkuar tej mase me raste përmbareme, këto gabime dhe dështime që duken të jenë tërësisht nën kontroll të kreditorit, janë shqetësuese.

Rastet në të cilat debitori i aktgjykimit është subjekt publik paraqesin sfida të posaçme për përmbareme.⁶⁷ Shembulli i rastit në vijim ilustron vështirësitë me të cilat

⁶⁶ KGJK, *Raporti për vitin 2010: Statistikat mbi Gjykatat e Rregullta*, faqe 18, fusnota e sipërme 4; informacion i marr përmes intervistave me gjyqtarë dhe referentë përmbareme, më sipër në fq. 6 të këtij raporti.

⁶⁷ Komisioni Evropian, në *Raportin e vet të Progresit në Kosovë për vitin 2010*, nënvizon se disa komuna "vazhdimisht kanë refuzuar të i zbatojnë vendimet gjyqësore": fusnota e sipërme 2, fq. 11. Shih po ashtu, Departamenti i Shtetit të SHBA-ve, *Raporti për të Drejtat e Njeriut për vitin 2009: Kosova*, i cili vë në dukje probleme të vazhdueshme më përmbaremin e urdhrave gjyqësore civile ku subjekti publik ishte objekt i urdhrit. Raporti për vitin 2009 nënvizoi, "Për shembull, pas marrëveshjes për zgjidhje e 19 majit komuna e Deçan/Dečane publikisht deklaroi se nuk do t'i ndryshonte regjistrat e kadastrës komunale pa marrë parasysh vendimin eventual të odës së veçantë të gjykatës supreme për Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit. Rasti është i lidhur me një kontest pronësor ndërmjet disa ndërmarrjeve jo-funksionale në pronësi shoqërore dhe Manastirin Visoki në

ballafaqohet qytetari i zakonshëm që tenton të përmbarojë një aktgjykim civil kundër një subjekti të madh publik.

Debitori kishte ndërtuar një termocentral në tokën që ishte në pronësi të kreditorit. Me 6 tetor 2006, kreditori kishte marr një aktgjykim nga gjykata komunale në rajonin e Gjilan/Gnjilane që obligonte debitorin të heq dorë nga posedimi i tokës dhe të ja kthejë atë kreditorit brenda 15 ditëve. Debitori parashtroi ankesë kundër aktgjykimit; me 5 shkurt 2008, gjykata e qarkut e hodhi poshtë ankesën si të pabazë. Me 26 qershor 2008, kreditori, pasi që vërejti se debitori kishte dështuar të zbatojë aktgjykimin vullnetarisht, parashtroi kërkesën për përmbarim. Me 4 korrik 2008, gjykata lëshoi një vendim me të cilin aprovonte propozimin e kreditorit. Ndërmjet gushtit 2008 dhe dhjetorit 2010, debitori parashtroi dy kundërshtime, një kërkesë për shtyrje, një kërkesë për ngritje të akuzave penale, një kërkesë për ri-dëgjim të rastit mbi merita dhe një kërkesë që gjyqtari përmbarimor të largohet nga rasti. Të gjitha këto kundërshtime dhe kërkesa menjëherë ishin hedhur poshtë si të pabaza. Deri në shkurt 2011, aktgjykimi i vitit 2006 ka mbetur i papërmbaruar.

Për më shumë se katër vite pas shpalljes së aktgjykimit, kreditori nuk e kishte më afër që t'i kthehet toka e vet, se sa që e kishte në ditën kur u shpall aktgjykimi. Vonesat në përmbarimin e aktgjykimit ishin sjell vetëm për shkak të ankesave, kundërshtimeve e kërkesave të shumta – të gjitha nga të cilat menjëherë ishin gjetur si të pabaza. Vonesa e tillë e vazhdueshme shkel të drejtën e kreditorit për gjykim të drejtë brenda kohës së arsyeshme. Veç kësaj, sjellja e debitorëve në parashtrimin e ankesave, kundërshtimeve dhe kërkesave të pabaza mund të përbëjë abuzim me procesin gjyqësor. Ligji për Procedurën Përmbarimore nuk duket të parashih këtë situatë; nuk ofron ndonjë mekanizëm për shqiptimin e dënimeve ndaj debitorëve të aktgjykimeve të cilët kërkojnë që të vonojnë proceduarat duke parashtruar ankesa, kundërshtime e kërkesa të shumëfishta të cilat përfundimisht përcaktohen si të pabaza.

Rasti në vijim paraqet një grup edhe më shqetësues faktesh.

Në janar të vitit 2009, paditëses, një nxënëseje 15 vjeçare të shkollës së mesme, i ishte tërhequr vërejtja verbalisht nga autoritetet e shkollës që asaj do t'i duhet të zgjedhë ndërmjet asaj se a do të mbante shaminë apo të vijonte mësimin; ajo ishte këshilluar se po që se vazhdon ta mbajë shaminë e kokës në shkollë do të përjashtohet nga mësimi. Pas kësaj vërejtjeje, paditësja ndaloi vijimin e mësimave. Në prill të vitit 2009, ajo inicioi një procedurë administrative në përpjekje që ta shtynte Departamenti për Arsim në komunën ku ajo banonte që t'i lejojë të i kthehet vijimit të mësimit derisa mbante shaminë e kokës. Kjo procedurë ishte e pasuksesshme; si rezultat, në shtator të vitit 2009, paditësja filloi procedurën pranë gjykatës supreme kundër Departamentit për Arsim. Më 19 tetor 2009, gjykata supreme vendosi se nuk kishte juridiksion për të shqyrtuar rastin dhe e referoi lëndën në gjykatën e qarkut. Me 17 nëntor 2009, gjykata e qarkut vendosi në të mirë të paditëses, duke gjetur se Departamenti për Arsim nuk ka pasur baza ligjore për ta kërcënuar paditësen me largim nga mësimi dhe e ka obliguar departamentin që

Deçan/Deçane.” <http://www.state.gov/g/drl/rls/hrrpt/2009/eur/136039.htm> (i qasur më 25 korrik 2011).

ta lejojë kthimin e saj. Departamenti për Arsim nuk kishte parashtruar ankesë ndaj këtij vendimi por deri më sot ka refuzuar ta zbatojë atë. Në një intervistë me monitoruesin e OSBE-së, zyrtarët komunal kishin thënë se nuk u interesonte se çfarë kishte vendosur gjykata, dhe ishin të vendosur se nuk kishin ndër mend ta ri-pranojnë nxënësen në mësim përderisa ajo mban shaminë në kokë.

Komentet e zyrtarëve komunal të intervistuar nga monitoruesi i OSBE-së paraqesin atë që mund të përshkruhet si mospërfillje e plotë ndaj autoritetit të gjykatave. Përderisa çështja në qendër të këtij rasti është qartë kontestuese dhe është e atillë për të cilën palët kanë mendime të kundërta megjithatë është një çështje për të cilën ka vendosur gjykata. Departamenti për Arsim ka mundur të parashtronte ankesë ndaj vendimit pranë gjykatës supreme, e po që se e domosdoshme edhe pranë gjykatës kushtetuese. Ka zgjedhur të mos e bëjë këtë dhe në vend të kësaj duket të jetë i kënaqur vetëm me mospërfilljen e vendimit. Vonesa e vazhdueshme në zbatimin e vendimit shkel të drejtën e paditëses për gjykim të drejtë brenda kohës së arsyeshme, dhe i kontribuon shkeljes së vazhdueshme të së drejtës së saj për arsimim.⁶⁸ Duke folur praktikisht, nëse vendimi nuk zbatohet shumë shpejtë, mundësia për ta zbatuar atë mund të humbet përgjithmonë; paditësja që ishte 15 vjeçare në kohën e ngjarjeve përkatëse, tani është 18 vjeçare dhe shpejt do ta kalojë moshën kur pritet që normalisht të vijojë shkollimin e mesëm. Këto fakte me të vërtetë mund të sugjerojnë se rasti është i natyrës urgjente dhe është një nga të cilët, sipas praktikës gjyqësore të GjEDNJ-së institucionet janë të obliguara ta trajtojnë me shpejtësi të veçantë.⁶⁹

4. EKZEKUTIMI I AKTGJYKIMEVE PENALE NË KOSOVË

Në kontrast me vështirësitë e shumta të hasura me aktgjykime civile, gjatë ekzekutimit të aktgjykimeve penale haset në vështirësi dukshëm më të pakta. Siç ceket në fillim të këtij raporti në vitin 2010 është shënuar një rritje përfundimtare e përafërsisht 17.46% të rasteve të pa përmbaruara civile krahas një rritjeje përfundimtare prej vetëm 4.44% të rasteve të pa përmbaruara penale.

Kjo pjesë e raportit kufizon shtrirjen e shqyrtimit në tri shqetësime kryesore lidhur me ekzekutimin e aktgjykimeve penale dhe vendosjen e sanksioneve. Së pari, shpesh ka vonesë dhe jo-transparencë ndërmjet kohës së aktgjykimit verbal dhe atij me shkrim. Së dyti, adresat e pasakta të të pandehurve shpesh rezultojnë në vështirësi për të gjetur vendndodhjen të pandehurve kur aktgjykimi me të cilin është shpallur dënimi me burg apo gjobë merr formën e prerë. Dhe së treti, ka mungesë të trajnimit për referentët që janë përgjegjës për ekzekutimin e këtyre aktgjykimeve.

⁶⁸ Shih Nenin 28 të Konventës për të Drejtat e Fëmijës, Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të KB-ve 44/25, 20 nëntor 1989, hyri në fuqi me 2 shtator 1990.

⁶⁹ Duke vlerësuar se a është një vonesë e veçantë e arsyeshme, GjEDNJ merr për bazë se cila është çështja në qendër të lëndës gjyqësore. Shih inter alia, *Frydlender kundër Francës*, Aktgjykim i GjEDNJ-së i 27 korrikut 2000 paragrafi 43. Shih po ashtu *Buchholz kundër Gjermanisë*, Aktgjykim i GjEDNJ-së i 6 majit 1981, paragrafi 52 dhe *Sylvester kundër Austrisë*, Aktgjykim i GjEDNJ-së, i 3 shkurtit 2005, paragrafi 32.

Aktgjykimi me shkrim duhet të përmbajë datën kur është shpallur vendimi i gjykatës.⁷⁰ Megjithatë, nuk ka kusht për ta përfshirë në aktgjykimin me shkrim datën kur vendimi i gjykatës është vendosur në formë të shkruar.

OSBE më parë ka raportuar lidhur me vonesat e mëdha ndërmjet aktgjykimeve verbale dhe atyre me shkrim.⁷¹ OSBE vazhdon të vërejë vonesa. Në disa raste kalojnë muaj para se aktgjykimi verbal të konvertohet në aktgjykim me shkrim. Por kur vendimi i gjykatës vendoset në formë të aktgjykimit me shkrim, gjyqtari e nënshkruan pa datë nënshkrimi. Mungesa e datës së nënshkrimit jep përshtypjen se është nënshkruar në datën e shpalljes verbale të tij. Kjo e bën të vështirë të monitorohet nëse gjykata qëndron në përputhshmëri me kërkesat kohore të parapara me kod në lidhje me aktgjykimin “që duhet të përpilohet me shkrim brenda pesëmbëdhjetë ditë nga shpallja e tij kur i akuzuari gjendet në paraburgim, ndërsa brenda tridhjetë ditë në raste të tjera”.⁷²

Vetëm kur monitoruesit shikojnë shkresat e lëndëve në kohë të ndryshme, ose pyesin gjyqtarët drejtpërdrejtë, OSBE mund të vlerësojë periudhën kohore në të cilën këto vendime vendosen në aktgjykime me shkrim. Shembujt në vijim ilustronë shkeljet e vërejtura të ligjit, shkelje të cilat nuk do të mund të vëreheshin pa monitorim aktiv.

Në një rast pranë gjykatës së qarkut në Pejë/Peć që përfshinte një të pandehur të akuzuar sipas Kodit Penal të Kosovës⁷³ për kryerjen e veprës penale trafikim me njerëz⁷⁴ dhe dhunim⁷⁵, shpallja vendimit të gjykatës ishte bërë me 25 tetor 2010. Deri nga 24 shkurti 2011, ende nuk është lëshuar aktgjykimi me shkrim.

Në një rast pranë gjykatës së qarkut në Prishtinë/Priština, një i pandehur ishte gjykuar për kryerjen e veprës penale të rrezikimit të trafikut publik⁷⁶. Shpallja verbale u bë me 26 nëntor 2010, po u deshën pothuajse tre muaj që të lëshohet aktgjykimi me shkrim. Ishte lëshuar me 18 shkurt 2011.

Në një rast pranë gjykatës së qarkut në Pejë/Peć që përfshinte tre të pandehur të akuzuar për trafikim me njerëz⁷⁷ vendimi i gjykatës ishte shpallur me gojë me 23 dhjetor 2010. Deri nga 24 shkurti 2011, ende nuk është lëshuar aktgjykimi me shkrim.

Për më tepër, kur aktgjykimi që cakton dënim me burg apo gjobë monetare merr formim e prerë, marrja e pasaktë e adresave të të pandehurve shpesh rezulton në

⁷⁰ Neni 396(2), KPPK.

⁷¹ Raporti i OSBE-së “*Katër Vite më Vonë: Ri-Përcjellja e Rasteve të Trazirave të Marsit 2004 në Sistemin e Drejtësisë Penale në Kosovë*” (korrik 2008), faqet 11 dhe 12. http://intranet/documents/09081304_1257_sq.pdf (e qasur më 25 korrik 2011).

⁷² Neni 395(1), KPPK.

⁷³ Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës, i shpallur përmes Rregullores së UNMIK-ut 2003/25, 6 korrik 2003, me ndryshimet pasuese. Me 6 nëntor 2008, Parlamenti i Kosovës ka shpallur Ligjin Nr. 03/L-002 mbi Ndryshimin dhe Plotësimin e Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës Nr 2003/25, që la ligjin përmbajtësish të njëjtë me ligjin e vitit 2003, me vetëm një pjesë të shtuar për aranzhimet lidhur me deklaratimet për fajësi dhe ndryshimin e emrit të ligjit në Kodi Penal i Kosovës, prej këtu e tutje i referuar si KPK.

⁷⁴ Neni 139 KPK.

⁷⁵ Neni 193 KPK.

⁷⁶ Neni 297, paragrafi 5 lidhur me paragrafët 3 dhe 1 të KPK-së.

⁷⁷ Neni 139 KPK.

vështirës në gjetjen e vendndodhjes së të pandehurve. OSBE ka vërejtur se adresat e pasakta krijojnë pengesë për ekzekutimin e sanksioneve. Nëse ka vonesë në dërgesën e dokumenteve tek i pandehuri kjo do të vonojë ekzekutimin e aktgjykimit përfundimtar apo vendosjen e sanksionit.⁷⁸ Sipas shumicës së referentëve për ekzekutime në gjykatat komunale, sigurimi i adresave të sakta të palëve është pengesa kryesore në ekzekutimin e aktgjykimeve.⁷⁹

Nga fundi i vitit 2010 dhe fillimi i vitit 2011, OSBE ka kontaktuar referentët komunal që implementojnë ekzekutimin e aktgjykimeve. Referentët për ekzekutime kanë deklaruar se kanë mungesë personeli dhe se nuk kanë trajnim të mjaftueshëm.⁸⁰ Shumë referentë për ekzekutime pranë gjykatave komunale po ashtu nuk kishin dijeni lidhur me ligjin e ri që rregullon ekzekutimin e aktgjykimeve penale. As njoftimi e as kopje të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale⁸¹ nuk kishin arritur tek këta referentë.⁸² Edhe pse komponentë kritike për implementimin efektiv të ligjit, shumë referentë ende i referoheshin dhe punonin sipas Rregullores së UNMIK-ut 2004/46 mbi Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.⁸³

5. PËRFUNDIM

Ky raport ka nënvizuar vonesat e mëdha dhe mangësitë procedurale në përmbarrimin/ekzekutimin e aktgjykimeve civile dhe penale në gjykatat e Kosovës. Lëndët përmbarrimore që përfshijnë aktgjykimet për faturat e papaguara për shërbime komunale janë identifikuar si veçanërisht problematike, si për shkak të numrit të madh të tyre ashtu edhe për shkak të pasaktësive në propozimet për përmbarrime që kompanitë komunale të shërbimeve ja parashtrojnë gjykatave. Kategoria e dytë e lëndëve përmbarrimore është identifikuar të jetë edhe më problematike dhe përfshin subjektet publike se debitorë të aktgjykimeve. Në rastet e monitoruara nga OSBE ku komuna ose ndonjë tjetër subjekt publik e gjen veten në pozicion që të implementojnë aktgjykimin, shumë shpesh ky subjekt kërkon që të vonojë përmbarrimin me ankesa apo kundërshtime të pabaza ose, çfarë është edhe më keq, thjesht e injoron aktgjykimin.

Përmbarrimi/ekzekutimi i aktgjykimeve gjyqësore civile dhe penale është një pjesë integrale e së drejtës fundamentale të njeriut për gjykim të drejtë brenda kohës së arsyeshme. Kur, siç është rasti sot në Kosovë, aktgjykimet civile nuk përmbarrohen brenda kohës së arsyeshme, shkelet e drejta për gjykim të drejtë dhe komprometohet sundimi i ligjit. Vonesat e mëdha në përmbarrimin e aktgjykimeve civile shkaktojnë

⁷⁸ Raporti i OSBE-së, *Shqyrtimi i Sistemit të Drejtësisë Penale në Kosovë “Administrimi i drejtësisë në gjykatat komunale”* (mars 2004), faqe 15. http://intranet/documents/410_2.pdf (i qasur më 25 korrik 2011).

⁷⁹ Intervista të OSBE-së me administratorë të gjykatave komunale në rajone të shumta, të kryera në nëntor dhe dhjetor 2010.

⁸⁰ Ibid.

⁸¹ Ligji Nr. 03/L-191 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, 22 korrik 2010.

⁸² Personeli në zyrat e përmbarrimeve në disa gjykata nuk ishin në dijeni se ligji në fuqi për përmbarrimin e sanksioneve penale është Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale e jo Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2004/46. Intervistat e OSBE-së me referentë përmbarrimor në gjykatat komunale të kryera në nëntor dhe dhjetor 2010.

⁸³ Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2004/46 mbi Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, e shpallur me 19 nëntor 2004.

rritje të numrit të këtyre lëndëve. Problemet lidhur me vonesat dhe numrin e pazgjdhur të lëndëve komplikohen edhe më tej kur dy llojet e rasteve të identifikuar si më problematike të dyja përfshijnë subjekte publike. Kur subjektet publike në rolin e tyre si kreditorë të aktgjykimeve e mbingarkojnë sistemin e përbarimeve me dokumentacion të pasaktë apo të pakompletuar, ato sinjalizojnë pakujdesi shqetësuese dhe së fundmi mungesë respekti për funksionimin e sistemit të tyre të drejtësisë. Kur subjektet publike, në rolin e tyre si debitorë të aktgjykimeve ndalojnë përpjekjet për përbarim apo thjeshtë injorojnë aktgjykimet kundër tyre, ato sinjalizojnë diçka edhe më shqetësuese: shpërfillje ndaj sundimit të ligjit.

Në aktgjykimet penale, shpesh ka vonesa në mes të kohës së aktgjykimit të shpallur në formë gojore dhe aktgjykimit në formë të shkruar, që rezulton në vonesë para se aktgjykimit të jetë i gatshëm për të u përbaruar. Adresat e pasakta të të pandehurve shpesh krijojnë pengesa në gjetjen e vendndodhjes së të pandehurve kur aktgjykimi mbi dënimin me burg apo gjobë monetare bëhet i përbarueshëm. Gjithashtu ka mungesë trajnimi për referentët komunal për ekzekutime.

Institucionet kompetente në Kosovë “kanë obligimin pozitiv që të organizojnë një sistem për zbatimin e vendimeve, i cili është efektiv edhe në kuptimin ligjor edhe në atë praktik, si dhe i cili siguron zbatimin e tyre pa vonesa të panevojshme”.⁸⁴ Ky obligim pozitiv paraqet domosdoshmërinë për një qasje pro-aktive ndaj problemeve me të cilat aktualisht po ballafaqohet sistemi i drejtësisë në zvogëlimin e numrit të lëndëve përbarimore/ekzekutive. Strategjia KGJK-së për Reduktimin e Lëndëve të Vjetra në Kosovë është një iniciativë e mirë dhe ka potencial që të ketë ndikim domethënës në zvogëlimin e numrit të madh të lëndëve përbarimore/ekzekutive. Megjithatë, për të pasur këtë ndikim ajo duhet të implementohet shpejtë dhe në mënyrë efektive. Në kohën e hartimit të këtij raporti ndonëse është shënuar progres i caktuar në zvogëlimin e numrit të përgjithshëm të lëndëve të pakryera nga ana e gjykatave të Kosovës, zbatimi i Strategjisë duket të ketë pasur ecuri të ngadalshme. Në veçanti, në lidhje me masat që i adresojnë lëndët përbarimore, duhet të bëhet progres i mëtutjeshëm në mënyrë që të sigurojë që Strategjia të zvogëloj me sukses numrin e përbarimeve të aktgjykimeve në Kosovë.

6. REKOMANDIME

Për Asamblenë e Kosovës:

- Të merr parasysh ndryshimin e Ligjit për Procedurën Përbarimore që të krijojë një procedurë ekspeditive për përbarimin e aktgjykimeve në rastet e faturave të papaguara për shërbime komunale
- Të merr parasysh ndryshimin e Ligjit për Procedurën Përbarimore që të krijojë dënime për debitorin e aktgjykimit, për parashtrimin e ankesave, kundërshtimeve dhe/ose kërkesave të pabaza
- Të merr parasysh ndryshimin e Ligjit për Procedurën Përbarimore që të transferoj obligimin për të siguruar adresën e debitorit sipas rekomandimit të

⁸⁴ Fusnota e sipërme 27, paragrafi 62.

Strategjisë Shtetërore për Reduktimin e Numrit të Lëndëve të Vjetra, nga gjykatat tek kreditori

Për kryetarët e gjykatave:

- Të caktojnë grupet punuese siç është e paraparë me Strategjinë Shtetërore për Reduktimin e Lëndëve të Vjetra në Kosovë dhe të mbikëqyr fillimin e menjëhershëm të punës së tyre.

Për gjyqtarët civil:

- Të njoftohen me aktgjykimin e kohëve të fundit të Gjykatës Kushtetuese në rastin e *Sindikata e Pavarur e Punonjësve të Fabrikës së Çelikut IMK Ferizaj*, vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të gjykatës komunale në Ferizaj/Uroševac,⁸⁵ veçanërisht pjesën e aktgjykimit që obligon gjykatat e Kosovë që të përmbarojnë vendimet “pa vonesa të panevojshme”.
- Të marrin parasysh përdorimin e gjobave monetare dhe sanksioneve tjera të parapara me Ligjin për Procedurën Kontestimore që t’i shtyjnë palët në procedura përbarimore të veprojnë në pajtim me ligj.

Për gjyqtarët penal:

- Në aktgjykimet e formës së shkruar gjyqtarët duhet të përfshijnë datën kur nënshkruhen ato.
- Gjyqtarët duhet të verifikojnë që adresat e siguruar të të pandehurve të jenë të sakta.

Për Institutin Gjyqësor të Kosovës:

- Të vazhdojë trajnimin e gjyqtarëve dhe referentëve për përbarime/ekzekutime në procedura përbarimore/ekzekutive civile dhe penale.
- Trajnimet do të duhej të sqarojnë rëndësinë e marrjes së saktë të adresave së pjesëmarrësve në gjykime, veçanërisht ato të të pandehurve.

⁸⁵ Ibid.